



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2023-003**

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj**, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala E.Q., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren dhe gjyqtarëve tjerë të kësaj gjykate, me datë 03.03.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala E.Q., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë – Sh.E., dhe gjyqtarëve tjerë të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Pala E.Q., nga Komuna e Dragashit, më 3 shkurt 2023, ka paraqitur ankesë ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren, Sh.E., si dhe gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Prizren, A. S., L.B., dhe F.K., të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit jo kompetent, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 3 shkurt 2023, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka përcjellë ankesën me 6.03.2023 tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetares të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesi i ankesës E.Q., në ankesën e tij thekson procedurat penale të zhvilluara ndaj tij dhe veprat penale për të cilat është akuzuar, duke pretenduar se gjyqtaret dhe prokuroret nuk kanë vepruar drejt ndaj tij respektivisht kanë keqpërdorë detyrën e tyre. Kështu, sa i përket gjyqtarit

L.B., pretendon se ky gjyqtar kishte caktuar paraburgimin në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij për shkak se e kishte kërcënuar prokurorin, pastaj, kishte bërë ankesë në Gjykatën e Prizrenit dhe një kallëzim penal, mirëpo, ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës A.S., ju ka përgjigj me tallje. Gjyqtari F.K., i kishte shqiptuar një gjobë edhe pse kishte propozuar shtatë dëshmitarë, por gjyqtari nuk i kishte thirr dëshmitaret, kurse ka një vendim famëkeq nga Gjykata e Prizrenit 773/2017 nga ish gjyqtarja, tash kryetare e Gjykatës, e cila e kishte dënuar me gjobë në shumë prej pesëdhjetë (50) €.

Meqë, ankesa e paraqitur nga pala i lartë cekur përmbante informata të papërcaktuara si autoritet kompetent konform nenit 6 par.5 të Rregullores për procedurë disiplinore kam kërkuar informata plotësuese nga ankuesi, i cili përmes postës i ka dërguar informatat plotësuese. Në informatat plotësuese ankuesi e përsëritë ankesën duke ia bashkëngjitur vendimet gjyqësore të cilave ju është nënshtruar gjatë proceseve të cilat janë zhvilluar ndaj tij.

Si autoritet kompetent pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura vlerësoj se ankesa në rastin konkret është dukshëm joserioze, ngase kryesisht ka të bëjë me procesin e vendimmarrjes së gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe pakënaqësinë e tij rreth vendimeve të marra, të cilat janë shqyrtuar në procedura të rregullta gjyqësore dhe në këtë drejtim është vendos me aktgjykim. Në këtë drejtim si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes dhe vendimit të marr nga gjyqtari i çështjes. Kurse, pretendimet sa i përket veprimeve të gjyqtareve me asgjë nuk i argumenton.

Pra, vlerësoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren, në kohën kur ka qenë gjyqtare, e as gjyqtarët e tjerë të cekur në ankesë kanë kryer shkelje disiplinore.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.1 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Palës ankuese,
3. Arkivit të Gjykatës Supreme.